



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2596/1 Prot
Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

Tiranë, më 13/10 /2020

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____

DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.232 prot, datë 05.10.2020 “Njoftim për vend të lirë pune (mundësi për lëvizje paralele) ” të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier, protokolluar në AKPA me nr.2596 prot, datë 07.10.2020,

-Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier, për pozicionet:

- a) 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik në drejtimin Instalues dhe mirmbajtës rrjeti elektrik (Fier)
- b) 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik në drejtimin hidraulik (Fier)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier

Aplikanti për mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojnë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në ofruesit e formimit profesional si vijon:

- a) të ketë minimalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 13.10.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Fier të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionet:

- a) 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik në drejtimin Instalues dhe mirmbajtës rrjeti elektrik (Fier)
- b) 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik në drejtimin hidraulik (Fier)

në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Drejtorja Rajonale e Formimit Profesional Publik Fier brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Drejtorisë Rajonale e Formimit Profesional Publik Fier, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier.

DREJTORI PËRGJITHSHËM



Elira DEMIRAJ